Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Genc Zogaj	**10.11.2023**	**17.11.2023**	**2023/0869**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 05.11.2023, OE “Dyqani i Pavarur Tregtar Autopjese " Buqa "”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0869, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “Ideal Shala B.I- lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me pjese per automjetet Shkoda Rapid –te” me nr. të prokurimit: "214-23-1137-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedur? t? hapur, negocuar, kufizuar, lloji i kontrat?s: furnizim, vlera e parashikuar e kontrat?s: xx,xxx €. Lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0377 i dt:09.10.2023. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 (LPP),
Neni 7 (LPP),
Neni 51 (LPP),
Neni 59 (LPP),
Neni 60 (LPP),
Neni 72 (LPP),
Neni 99.2 (LPP)

AK ka ber shkelje te nenit 59 ku ne rastin konkret komisioni i vlerësimit nuk ka arritur te beje Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve ne pajtim te plot me ligjin dhe kriteret e përcaktuara nga vet AK ne rastin konkret AK e konsideron te përgjegjshëm një (i cili nuk i plotëson kriteret kualifikuese për kontratat e realizuara përfunduara ne vlerën e kërkuara nga ana e AK ku kriteri kualifikues i AK është "Operatori ekonomik duhet te ofroj dëshmi se ka përfunduar kontrata të natyrës sënjëjtë apo të ngjashme gjate 3 viteve te fundit (nga e publikimit të njoftimit për kontratë) jo me pak se 400,000.00 €.

I njëjti OE nuk e plotëson Kërkesën e lartcekur të dosjes së tenderit për faktin se nuk ka ofruar dës të mjaftueshme se i njëjti ka përfunduar projekte të natyrës së kontratës se në tri vitet e shkuara në vlerën e kërkuar 400,000.00 € si dhe flet dorzimet e mallit që janë ngarkur në sistem si dëshmi pë kryerjenë e shërbimeve nuk janë konform kërkesës së AK-së janë të mangeta pasi që nuk ka as nr. prokurimit e as emer të kontratës e as vleren e kontratës siq është kërkuar në dosjen e tenderit.

Kur analizohet dokumentacioni i OE të rekomanduar për kontratë, të cilat i ka prezantuar me o shihet se i njëjti nuk e plotëson kërkesën e AK-së pasi qëne listën e kontratave ka prezantuar kon që nuk janënjëjta apo te ngjashme me qëllimin e vet aktivitetit te prokurimit qe ka beje vetme pjese rezerve për automjete, në listën e kontratave te prezantuar nga OE i rekomanduar ka kon dhe referenca që nuk janë te natyrës se njejt apo te ngjashme me këtë tender,

KRITERET PËR VLERËSIM

a) Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës se njëjte apo të ngjashme gjatë 3 (tri) vitet e fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontrate) jo me pak se 400,000.00 €

a) Listën e kontratave të realizuara gjatë tri viteve të fundit (nga data e publikimit të këtij njoftimit për kontrate) e nënshkruar dhe vulosur nga OE. Referencat ose fletët pranimet në kopje të nënshkruar dhe vulosur nga Autoritet për përkatës të cilat duhet të tregojnë, numrin e

prokurimit ose kontratës, vlerën e kontratës, datën e nënshkrimit të kontratës, dhe vendin e realizimit të furnizimeve. Vërejtje Asnjë kontrate nuk do te llogaritet nëse nuk është e bashkangjitur referenca pozitive për kryerjen e furnizimeve ose raportet e flete pranimeve te furnizimeve kur furnizimi është bërë për një autoritet publik apo privat në Kosovë ose ne një vend tjetër, për dëshmi duhet te dorëzohen fletëpranimet ose referencat (ne referenca te jete e cekur vlera e furnizimeve, shërbimeve ose punëve) te lëshuara nga autoriteti i tillë

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Titulli i kontratës: Furnizim me pjese per automjetet Shkoda Rapid –të Ri-vlerësim

Nr. i prokurimit [2]	214-23-1137-1-1-1
Nr i brendshëm	214/23/007/111

Nr.	Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës	Vlera totale e ofertave
1.	Grup i Operatorëve Ekonomik Dyqani i Pavarur Tregtar Autopjesë Buqa ; Ndërmarrja Tregtare Private Ardhmeria Përparimi, PRIZREN	5,493.09 €
2	" Reforma " SH.P.K. Obiliq, OBILIQ 600158126	8,566.65€
3	Ideal Shala B.I. Parku i Biznesit Drenas, Drenas 810252114	5,168.55 €

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:

Policia e Kosovës shpërblen me kontratë OE" Ideal Shala "B.I. Parku i Biznesit Drenas në vlerë totale 5,168.55 €

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0377 i dt:09.10.2023.

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Dyqani i Pavarur Tregtar Autopjesë " Buqa "**

Me date 09.10.2023 PSH nxjerre vendimin me nr. 2023/0377 mbi pretendimet e OE ankues "Autopjese Buqa"-Prizren ku ankesa eshte pranuar si pjeserisht e bazuar, mbi te cilin ipen sqarime dhe kerkesa drejtuar AK qe gjate rivleresimit te sqaroje çeshtjen e vleresimit te ofertave dhe kontratave per pune te ngjashme duke i klasifikuar ato ne furnizime ose sherbime dhe duke kerkuar qe mos te ndahen por te mirren si te teresishme.

Lidhur me këtë çështje PSH arrin në konstatim se përderisa vlerësimi i ofertave është bërë duk ndarë furnizimet nga shërbimet si dhe duke dalluar vlerën e tyre, PSH poashtu vlerëson se m qenë se kjo çështje nuk specifikohet në mënyrë decidive në legjislacionin në fuqi, ndërsa r opinionet dhe dispozitat e referuara si më lartë mund të arrihet në konstatimin se situatat referuara përmbajnë ngjashmëri dhe mund të aplikohen në rastin konkret, por në të njëjtën koh legjislacioni e poashtu kërkesat në NJK dhe DT gjithmonë i referohen "kontratës" si tërësi, poashtu duke u bazuar në praktikat e deri-tanishme si dhe tiparet themelore të LPP-së, PS konstaton se lidhur me këtë çështje AK në bazë të dokumentacionit të paraqitur (kontratav mund të konsiderojë apo jo një kontratë si tërësi, që do të thotë vlerën totale, e jo duke ndarë njëjtën si dhe duke pranuar atë pjesërisht.

Sa i përket aplikimit të sqarimit/informatave shtesë lidhur me referencën, si çështje e ngritu PSH konstaton se lidhur me këtë, legjislacioni në fuqi rregullon rastin specifik, konkretisl Udhëzuesi Nr.001/2023 Për Prokurimin Publik, neni 10.1 saktëson se në rastet kur : *Mungo referenca/certifikata e pranimit nga lista e kontratave të prezantuara,* përcaktohet që, *Mund kërkohen informata sqaruese* konform neneve 72 dhe 59 të LPP-së, andaj veprimi i ndërman nga ana e AK-së duke kërkuar sqarime lidhur me referencat si pjesë e listës së kontratave r ofertën e OE të rekomanduar konsiderohet se është në harmoni me këtë dispozitë.

Gjate rivleresimit AK konstaton se kjo kontrate e cila eshte me e madhja e derguar nga OE i propozuar per kontrate ne kete procedure tenderimi cilesohet si:

Ne lidhje me kontratën "Furnizim me pjese rezerve dhe mirëmbajtja e makinerisë se rende (buldozerëve)" kjo kontratë është klasifikuar sipas nenit 15 te LPP përkatësisht pikës 1 ku thuhet citoje "Nëse një kontratë për furnizim përmban dispozita që kërkojnë nga furnizuesi që të dërgojë, vendosin edhe/ose instalojnë artikullin/artikujt përkatës, ekzistenca e këtyre dispozitave, nuk do të ndikojë në klasifikimin e kontratës në fjalë si kontratë për " furnizim". Po ashtu sipas UDHËZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK neni 3. Klasifikimi i kontratave publike sipas vlerës paragrafi 3.5 Megjithatë, është e mundshme për një kontratë publike të jetë "kombinim": Furnizim/Shërbim, Punë/Shërbim; Punë/Furnizim; kombinim në Furnizim/Punë/Shërbime. Metoda bazike për të trajtuar këtë ndarje është gjithnjë modeli i kostos së thjeshtë. Cilido element i kontratës që ka shpenzimet më të larta të parashikuara, kontrata duhet të klasifikohet nën atë lloj të kontratës. Kjo duhet të aplikohet edhe nëse kontrata është ndarë në "Lote"; ajo do të jetë vlera totale e kontratës së plotë (të gjitha "lotet") si dhe duke ju referuar edhe klasifikimit sipas FPP

është si ne vijim:
AK-KMDK ka klasifikuar kontratën furnizim dhe sipas FPP si ne vijim:

Kodi	Përshkrimi ▲
34000000-7	Pjese te automjeteve motorike, rimorkiove dhe automjetave

Prano

Ndersa AK Policia e Kosoves ka klaisifkuar kontraten si Furnizim dhe ne FPP si ne vijim:

Kodi	Përshkrimi ▲	Niveli	Klasifikimi prind
34300000-0	Pjese dhe pajisje per makina dhe motor te tjere	2	Pjese te automjeteve motorike, rimorkiove dhe automjetave

Pra kodi 34000000-7 është kodi baze (Klasifikimi Prind) i klasifikimit për pjesë rezerve ndërsa kodi 34300000-0 është nen kod i tije.

Per kontraten ne fjale eksperti ka kerkuar sqarime shtese tek AK lidhur me ate se :

1. Ju lutem te mi dërgoni dëshmitë nëse i keni ato lidhur me përfundimin e kontratës. a ka dorëzuar OE ne fjale procesverbale te pranimit te anekseve/ dërgesave apo ndonjë reference per këtë projekt te përfunduar apo edhe datën kur është përfunduar kjo procedure prokurimi dhe ne baze te çfarë arsyetimesh komisioni i vlerësimit e ka marre parasysh llogaritjen e kësaj kontrate si reference e përfunduar per pune te ngjashme. Ngase ne dosjen e dërguar nga OE fuguron vetëm kontrata e nënshkruar dhe nuk ka detaje tjera.

Ne pergjigjen e derguar nga AK drejtuar ekspertit jane derguar dokumente, ku figurojne faturat e derguara per pjeset dhe furnizimet, ne te cilat faktura nuk eshte cekur emri i kontrates ne fjale dhe pervec nje emaili te shkruar nga AK te cilet pas pyetjes nga OE "Ideal Shala" se deshirojne nje konfirmim mbi ate se ky projekt eshte perfunduar me sukses ku edhe kemi kete pergjigje me shkrim pa ndonje evidence mbi referencen pozitive apo edhe kerkesen e ekspertit mbi daten e perfundimit te kesaj kontrate kornize 3 vjecare.

Arberie Fejza
to klmcmehmettinova, me

I nderuari Z. Tinova ,

Te lutem na konfirmoni me email se funrizimiet re mirembajtjet te cilat i kemi pas lidhur me kontarat ka qene ne rregulle eshe pse nuk kemi punuar me **FLETPRANIME** deklarauar e ne ATK **Furnizim me pjese reserve per Makinerin Liebhell me nr te prokurimit : KMDK-19-887-1-2-1**
Furnizim me pjese reserve dhe mirembajtja e makineris se rende (Bulldozhera) me nr prokurimi : KMDK-19-4022-1-1-1

I nderuar kjo kerkes eshte per tenderin te cilin kemi konkuruar tek POlicia e Ksoves Furnizim me pjese per Shkoda-Rapid

Edhe pse ne i kemi pranuar referncat nga ana juaj po kerkon deshmi qe qdo gje ka qene ne rreguli gjate funrizimit vetem me fatura tatimore (pa fletdregesa

Me respekt
Arberia

Mehmet Tinova
to Arberie, me

Pershendetje,

Te nderuar ne si AK konfirmojme se te dy projektet kane perfunduar ne rregull konform kontratave.

Gjitha te mirat!

--
Me respekt,
Mehmet Tinova
Drejtor i Prokurimit
KMDK SH.A
+383 44 130 028

Pas pergjigjes se pranuar, eksperti perseri i ka shkruar Autoritetit Kontraktues duke bere te çartë se mungon referenca apo pranimi teknik i kesaj kontrate kornizë dhe se ka kerkuar sqarime se si eshte vleresuar apo llogaritur kjo kontrate kornize dhe si eshte marre parasysh duke pare qe nuk ka reference zyrtare apo edhe pranim teknik zyrtar pervec emailit te lartecekur (ku AK shkruan me fjale se kjo kontrate ka shkuar gjithcka ne rregull), por qe eksperti nuk ka ne dispozicion nje date te perfundimit te kesaj kontrate. Andaj, duke e konsideruar edhe faktin qe kjo ankese ka qene shqyrtuar edhe nje here nga Paneli shqyrtues dhe eksperti i kaluar qe ka shqyrtuar kete lëndë ku eshte vënë ne diskutim kjo kontrate e lartëcekur, eksperti konsideron qe nese bazohemi ne Kerkesat e Dosjes se tenderit te shpallura nga vete autoriteti ku thuhet qe nuk do te llogaritet asnje kontrate nese nuk i eshte bashkangjitur referenca pozitive per kryerjen e furnizimimeve apo raportet e flete pranimeve, gjeni si me poshtë :

a) Listën e kontratave të realizuara gjatë tri viteve të fundit (nga data e publikimit të këtij njoftimit për kontrate) e nënshkruar dhe vulosur nga OE. Referencat ose fletët pranimet në kopje të nënshkruar dhe vulosur nga Autoritet për përkatës të cilat duhet të tregojnë, numrin e prokurimit ose kontratës, vlerën e kontratës, datën e nënshkrimit të kontratës, dhe vendin e realizimit të furnizimeve. Vërejtje Asnjë kontrate nuk do te llogaritet nëse nuk është e bashkangjitur referenca pozitive për kryerjen e furnizimeve ose raportet e flete pranimeve te furnizimeve kur furnizimi është bërë për një autoritet publik apo privat në Kosovë ose ne një vend tjetër, për dëshmi duhet te dorëzohen fletëpranimet ose referencat (ne referenca te jete e cekur vlera e furnizimeve, shërbimeve ose punëve) te lëshuara nga autoriteti i tillë.

Andaj, vetem nese vlerësohet ndryshe, eksperti konsideron qe duke pare per baze kete kerkese te dosjes dhe fakteve te pranuara nga eksperti dhe informatave shtese te marra konsiderojme qe nuk ka fakte te mjaftueshme dhe eksperti nuk eshte ne gjendje qe kjo kontrate te mirret per baze si kontrate e perfunduar pasi qe i mungon referenca perfundimtare mbi perfundimin e saj dhe se eksperti me kete rast nuk eshte ne gjendje te precizoje sakte se kur ka perfunduar kjo kontrate ne menyre qe te beje llogaritjen nese kjo kontrate eshte e barazvlefshme me kushtet e kerkuara ne DT per 3 vitet e fundit nga data e njoftimit te kesaj kontrate. Andaj, porpozon qe AK gjate rivleresimit te kesaj lende ta shqyrtoje kete pozicion dhe kete kontrate edhe njehere dhe ta sqaron si duhet daten e permbylljes te kesaj kontrate. Po te shohim edhe kontraten e lidhur ne vitin 2017 aty nuk ka ndonje datë të perfundimit por vetem ajo e nenshkrimit te saj qe eshte 30.01.2017 e qe nese bazohemi ne daten e njoftimit te kontrates se Dosjes se tenderit e cila eshte **02.03.2023,** i bie qe nese do te kishte perfunduar per 3 vite nga data e nenshkrimit do duhej te jete 30.01.2020

KMDK SH.A Dalëse ☐ Hyrëse ☑
Nr: 66/2017
Data: 30-01-2017
Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë Sh.A
Kosovo Landfill Management Company J.S.C
Kompanija za Upravljanje Deponijama na Kosovu DD

Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A
Kosovo Landfill Management Company J.S.C
Tel: 038 544 551, 544 552
Adresa: Rr. Mustafa Kokollari -1 Dardani
Prishtinë, Kosovë

KONTRATA KORNIZË

Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosove (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë;

dhe

''AGS'' n.p.sh (ne vazhdim "Furnizuesi"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për furnizimet e shënuara me poshtë:

Furnizim me pjesë rezervë dhe servisimi I tyre për Bulldozhera të KMDK-së

me numër identifikues: ***[16/016/111]***

Neni 1 **Lënda**

1.1 Lënda e kontratës do të jetë [dërgesa], [mirëmbajtja], nga Furnizuesi, i furnizimeve në vijim:
Furnizim me pjesë rezervë dhe servisimi I tyre për Bulldozhera të KMDK-së

Neni 2 **Kushtet e dërgesës**

2.1 **Afati kohor për dorëzim do të jetë: Kërkohet nga operatori Ekonomik që furnizimet e porositura nga Autoriteti Kontraktues të dërgohen në afat prej 7 deri 14 ditë max.ndërsa për materialin hargjues është i obliguar brenda 24 orëve të bëjë furnizimin.**

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë Në katër (4) Deponite Sanitare dhe një (1) Stacion Transferi te KMDK-së. (Prishtine,Prizren,Gjilan, Podujeve,Ferizaj).

Për paisjet të ofrohet garancioni 6 MUAJ.

2.3 Inkotermi[1] i zbatueshëm do të jetët *[shëno Inkotermin]*.

Neni 3 **Origjina**

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

[1] Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Gjithashtu, per ekspertin eshte diskutabile edhe menyra e dhene ne sqarimin e AK drejtuar OE ankues ne momentin e refuzimit te kerkeses per rishqyrtim ku thuhet qe : (gjeni me poshte pergjigjen e marre nga AK pika 1).

Pretendimi i juaj se OE i rekomanduar për kontrate ka kontrata te realizuara/përfunduara janë n vlerën vetëm prej 111,731.85€, është jo i saktë nga ana e Juaj.

Ne do të ju sqarojmë për secilën kontratë që është e realizuar/përfunduar gjatë 3 (tri) viteve t fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontrate) jo me pak se 400,000.00€ si në vijim:

1. **Furnizim me pjese rezerve dhe mirëmbajtja e makinerisë se rende (bulldozhera) me numër t prokurimi KMDK-19-4022-1-1-1, kontratë kornizë tri vjeçare vlerë prej 394,361.81€ ndërs vlera e furnizimeve te përfunduara/realizuara është 300,958.78€**
2. **Furnizim me pjese për automjete toyota 120 – Policia e Kosovës , ne vlere prej 5,799.97€,**
3. **Furnizim me pjese këmbimi për automjete – Posta e Kosovës, ne vlere prej 8,420.07€,**
4. **Furnizim me pjese, vajra dhe bateri për automjete – Toverlani, ne vlere prej 45,267.48€**
5. **Framework Contract for the supply of automotive spare parts no.6 –EULEX, vlera e realizua është 20,426.52€,**
6. **Furnizim me goma – Komuna e Mitrovicës se Veriut, ne vlere prej 3,000.00€,**

Gjithashtu , OE ankues atakon vendimin e AK duke pretenduar qe brenda kesaj kontrate ka faktura te cilat nuk perkojne me lemin e kontratave te kerkuara te ngjashme me furnizim me pjese rezerve se dhe brenda saj ka edhe fatura per saldim, bateria, gypa hidraulike, riparime te gypave etj: Gje qe eshte e vertet qe ne dosjet e derguara te disa faturave emertime te tilla ekzistojne dhe per kete arsye edhe PSH ne vendimin e marre per kete çeshtje ka parashtruar komentet e tyre drejtuar AK qe gjate rivleresimit ta shqyrtoje kete teme diskutabile mbi furnizime dhe sherbimet e ketij lloji. Po bashkengjisim nje pjese te ankeses nga OE:

Duke i eliminuar kontrat e larte shënuara atëherë kontrata qe OE i ka prezantuara e te cilat janë te realizuara përfunduara me sukses janë ne vlere vetëm prej **111,731.85**euro pasi qe OE ka deklaruar edhe fatura edhe me data pas hapjes se aktiviteit te prokurimit si dhe me sherbime qe nuk i perkasin kesaj lamie, si psh. Saldim, batrtia,gypa hidraulik, riparim i gypave etj, si dhe ne listen e kontratave ka pasur disa kontrtat qe te pa specifikuara se per kend jan kryer ato sherbim nuk ka prezantuar as kontrata e as fatura e as referenca.OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotëson kushtin e AK per kontrata te realizuara ne vlere prej **400,000.00** euro.

	A	B	C	D	E
1	NR.	Titulli i kontrates	Data e nenshkrimit te kontrates	Vlera totale e kontrates	Emri i Blerësit
2	2	Furnizim me pjese rezerve per makineri Liebherr	24.04.2019	€ 29'263.20	Kompania per Menaxhimin e Deponive ne Kosove Sh.A
3	3	Furnizim pjese per Automjete	13.05.2019	10,943.02	European Union of Law Mission in Kosovo
4	4	Furnizim me Pjese rezerve per makineri e rend Bulldozher	29.07.2019	€ 56'739.44	Kompania per Menaxhimin e Deponive ne Kosove Sh.A
5	10	Furnizim me pjese dhe vaje motorik	10.03.2020	€ 7'177.52	Telekomi
6	11	Furnizim me pjese per automjete Toyota 120	23.05.2020	€ 5'799.97	Policia e Kosoves
7	31	Furnizim me pjese kembimi per automjete	04.11.2021	€ 9'282.05	Telekomi
8	45	Furnizim me pjese per Nissan Terrano	19.12.2022	€ 3'519.17	Telekomi I Kosoves Sh.A
9					
10					

Sa i perket pretendimit te OE ankues lidhur me:

-OE i rekomanduar për kontratë e ka dërguar një autorizim nga një distributor INTER CARS i cili nuk dihet se a është i autorizuar pasi që në këtë autorizim ky është munduar të maipuloj edl me prodhuesit të cilët i ka cekur aty, pasi që është e pa mundur që të ketë marrëveshje me t gjitha ato kompani duke e pasur parasysh psh, Firma Mercedes-Benz, VW Grup nuk lësho autorizime për pjeset e veta e qe i ka cekur aty, OE i rekomanduar për kontratë në paramas ka cekur që disa pozicione që janë të cekura në vazhdim do ti furnizoj me pjesë nga këto kompani (Hella, Blic/EU, WW Grup) mirpo pas komunikimmit në email zyrtar këto kompani kanë dhën pergjigje se nuk i posedojnë fare këto pjesë.
-Andaj shihet qartë edhe një herë që ky OE i rekomanduar për kontrat është i pa përgjegjsh pasi që është munduar të manipuloj me informata të rrejshme e të cilat sipas ligjeve të prokurimit duhet të ndeshkohen dhe te merren masa sipas Nenit 99.2 te LPP-se per inform të rrejshme, (mashtruese).

Eksperti ka marre informata shtese nga AK ku vertetohet autorizimi me shkrim nga kompania INTERCARS e cila konfirmon per vertetesine e autorizimeve ne fjale dhe qe dokumentet e dorezuara nga OE Ideal Shala jane te nenshkruara dhe vulosura nga ana e kompanise ne fjale.

Dear Mrs. Krasniqi,

My name is Stefan Deyanov and I am sales director at Inter Cars Bulgaria Ltd., responsible for our distribution network and our export activities.

Herby I would like to confirm that the company *Ideal Shala BI (NPSH. Allmaks Global Services)* is our regular customer and the document presented to you is signed stamped by us at Inter Cars Bulgaria.

Inter Cars S.A. is the largest spare parts distributor in Central and Eastern Europe, presented in 19 countries with branch network and much more with regular export deliveries. The company is public and listed on the Warsaw stock exchange, an official distributor of more than 500 spare parts producers in the world, supplying parts for almost all car and truck manufacturers present in the Europe region.

https://intercars.eu/en

https://m-ri.intercars.com.pl/en/

Inter Cars Bulgaria Ltd. is owned 100% by Inter Cars S.A. and authorised by the mother company to service the markets of Bulgaria, Kosovo, Albania and North Macedonia.

We confirm we would supply regularly the spare parts needed for your cars to *Ideal Shala BI (NPSH. Allmaks Global Services)* as stated in the attached letter.

Best regards,

Stefan Devanov

Andaj, duke konsideruar kete fakt eksperti shqyrtues konsideron qe ky pretendim eshte i pabazuar dhe se pretendimet lidhur me dyshimet e OE ankues per manipulimet me autorizimet nuk mund te mirren parasysh nga eksperti ne mungese te fakteve tjera dhe mbeten vetem supozime te tilla.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe rekomandon që lënda të kthehet në rishqyrtim duke vënë theks te veçantë mbi llogaritjen apo jo të kontrates diskutabile mbi mungesen e referencës dhe dates se përfundimit te saj.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **POLICIA E KOSOVËS**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Dyqani i Pavarur Tregtar Autopjesë " Buqa "**

Genc Zogaj